



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 167 Prot.

Tiranë, më datë 12.02.2021

VENDIM
Nr. 52, datë 12.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.02.2021,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin zhvillimor “Ndërtimi i HEC Peshkëpi”, Bashkia Selenicë, me zhvillues “Bjorn sh.p.k.” dhe dhe raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Taulant Rama:
 - Subjekti zhvillues duhet të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të përgatisë një koncept sondazhi në kuadër të projektit;
 - Të verifikohet impakti i projektit në zonat kulturore dhe ndikimi në peizash;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRËTAR
Arta DOLLANI

